



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	11.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SACK	4196/2023		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.575/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.575/2023 të datës 28.03.2023 të parashtruar nga ankuesja

..... kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.05.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.575/2023 e datës 28.03.2023 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja ..... e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme- Agjencia e Regjistrimit Civil sipas Ndryshimit të Akt emërimit me numër reference 02-5942 të datës 14.12.2018 në pozitën “*Udhëheqëse e Sektorit për Letërnjoftime*” në Drejtoratin për Pajisje me Dokumente, me datën 28.03.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3051/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.265/2023 të datës 02.03.2023 të nënshkruar nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me caktimin e një zyrtari përgjegjës për hartimin e draftit fillestar Projekt Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2018 për Procedurën e Pajisjes me Letërnjoftim, me pretendim ankimore se emërimi i zyrtarit M.Shabani si zyrtar përgjegjës për hartimin e draftit fillestar të Projekt –Udhëzimit Administrativ për



Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ me Nr.05/2018 për Procedurat e pajisjes me Letërnjoftim, ka shkelje të Ligjit për Zyrtar Publik nr.06/L-114 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren (QRK) 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, Rregulloren nr.36/2023 për Organizimin e Brendshme, Rregulloren nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes së Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar. Me këtë rast e njëjta kërkon nga Këshilli që të anulohet vendimin për zyrtarin përgjegjës për hartimin e draftit për Udhëzimin Administrativ për letërnjoftime dhe të caktoj ankuesen si zyrtare përgjegjëse.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datën 24.04.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli: 3051/2023 të datës 28.03.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin e akt emërimit me numër 02-5942 të datës 14.12.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Letërnjoftimeve"; E-mailin e datës 21.03.2023 të A.Hoti drejtuar M.Thaqi; E-mailin e datës 20.03.2023 të A.Hoti drejtuar M.Thaqi; Vendimin me Nr.702/2019 të datës 13.10.2019; Vendimin me Nr.274/2020 të datës 06.04.2020; Vendimin me Nr.116/2021 të datës 25.02.2021; Vendimin me Nr.185/2022 të datës 09.02.2022; E-mailin e datës 08.06.2021 të S.Bilalli; E-mailin e datës 12.07.2021 të S.Bilalli drejtuar A.Kqira; E-mailin e datës 13.07.2021 të A.Hoti; E-mailin e datës 10.12.2021 të S.Bilalli; E-mailin e datës 06.10.2022 të S.Bolalli drejtuar A.Hoti; E-mailin e datës 02.02.2022 të M.Thaqi drejtuar A.Hoti; E-mailin e datës 02.02.2022 të A.Hoti drejtuar M.Thaqi; E-mailin e datës 03.02.2022 të A.Hoti drejtuar M.Yhaqi; E-mailin e datës 02.02.2022 të A.Hoti drejtuar M.Thaqi; E-mailin e datës 22.02.2022 të F.Ternava drejtuar M.Himaj; E-mailin e datës 22.02.2022 të A.Hoti drejtuar M.Himaj; E-mailin e datës 21.02.2022 të M.Thaqi drejtuar M.Himaj; E-mailin e datës 21.02.2022 të A.Hoti drejtuar M.Thaqi; E-mailin e datës 21.02.2022 të M.Thaqi drejtuar M.Himaj; E-mailin e datës 25.01.2022 të M.Thaqi drejtuar N.Shala; E-mailin e datës 07.07.2022 të A.Hoti drejtuar F.Ternava; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.04.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 24.04.2023; Akt emërimit nën shenjë Nr.Ref:DRGJC/ARC-1/13 të datës 31.01.2013 të nënpunësit M.Shabani; Ndryshim dhe plotësimin e akt emërimit të datës 01.12.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës "Udhëheqës i Qendrës për Pajisje me Dokumente" në Ministrinë e Punëve të Brendshme të datës 27.04.2015; Vendimin me numer 265 të datës 02.03.2023 të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:





Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja në ankesën e datës 28.03.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër protokollit 3051/2023 ka pretenduar që të anulohet Vendimin me Nr.265/2023 të datës 02.03.2023 të nënshkruar nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës për hartimin e draftit fillestar të Projekt Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2018 për Procedurën e Pajisjes me Letërnjoftim dhe të caktoj ankuesen si zyrtare përgjegjëse.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji..."*.

Se kush konsiderohet palë në procedurën administrative, Kolegji i'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative"*. Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë"*, kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se me Vendimin me numër Nr.265/2023 të datës 02.03.2023, nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses, i cili është i përcaktuar në mënyrë specifike lidhur me marrëdhënien e saj të punës e përcaktuar sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar të datës 14.12.2018, andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja Albana Hoti e datës 28.03.2023 është e paqëndrueshme dhe si e tillë hedhet poshtë si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që pozita dhe të drejtat që burojnë nga akti i përhershëm i themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht paga nuk i janë cenuar, po ashtu sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L -113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe Rregullores Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar është në diskrecion të Sekretarit të Përgjithshëm të caktoj zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e draftit fillestar të projektligjit apo aktit nënligjor, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa me numër A.nr.575/2023 e datës 28.03.2023, e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.






Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.575/2023.

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

  
Prëdesmbajtëse

Malsorë GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretares së Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së